



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më __.__.2024

VENDIM

Nr. 11, datë 18.01.2024

PËR

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 302, DATË 05.06.2023 “PËR
NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR VERIFIKIMIN E
KUSHTEVE DHE DOKUMENTACIONIT QË DUHET TË PLOTËSOJË
MAGJISTRATI (GJYQTAR) PËR TË PËRFITUAR KREDI PËR BANIM, SI
DHE MIRATIMIN E LISTËS SË MAGJISTRATËVE (GJYQTARË)
PËRFITUES NGA SKEMA E SUBVENCIONIMIT TË INTERESAVE TË
KREDISË ”, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenin 62, të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, vendimin nr. 738, datë 12.12.2023 të KLGJ, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, si dhe pas hedhjes së shortit nga radhët e gjyqtarëve,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e pikës 1, të vendimit nr. 302, datë 05.06.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor si më poshtë:

Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për verifikimin e kushteve dhe dokumentacionit që duhet të plotësojë magjistrati (gjyqtar) për të përfituar kredi për banim, si dhe miratimin e listës së magjistratëve (gjyqtarë) përfitues nga skema e subvencionimit të interesave të kredisë, i përbërë nga dy anëtar jogjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar, si më poshtë:

1. Znj. {...}, anëtare e KLGJ,
2. Z. {...}, anëtar i KLGJ,
3. Z. {...}, anëtar i KLGJ.

2. Ndryshimin e pikës 5, të vendimit nr. 302, datë 05.06.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor si më poshtë:

Komisioni, do ta ushtrojë veprimtarinë e tij, për periudhën nga hyrja në fuqi e këtij vendimi deri në datën 31.12.2024.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR